



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I ministrit

Cabinet of the minister

Kabinet ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Masat për përfundimin e procesit të rivendosjes së qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës

NUMËR: MASHT [I] 8/2006

DATË: 27.01.2006

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 Mbi e Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 4.1 paragrafet (b) dhe (m) të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe në bazë të nenit 17 paragrafet (1) dhe (2) të Statutit të Universitetit të Prishtinës, dhe pika V. e Udhëzimit Administrativ Nr. MASHT [I] 37/2005 për rivendosjen e qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

#### Neni 1 Qëllimi

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet dhe afatin e përfundimit të masave të parapara në Udhëzimin Administrativ Nr. 37/2005

- a. Mandati i Udhëzimit Administrativ Nr. 37/2005 do të vazhdohet deri në zgjedhjen e Rektorit të ri, por më së voni deri më 30 qershor 2006;
- b. MASHT do të rishqyrtojë procesin nëse ky nuk do të ketë përfunduar deri në datën e sipërpërmendur;
- c. Aspektet teknike të Udhëzimit Administrativ Nr. 37/2005 mbesin të pandryshuara.

#### Neni 2 Afati

Afatet dhe kornizat kohore të Udhëzimit Administrativ Nr. 37/2005, të cilat nuk janë realizuar, do të riformulohen ashtu që paragrafet përkatëse të përcaktojnë si në vijim:

Pika Q: “Rizgjedhjet do të organizohen nga ana e “zyrtarëve të lartë” dhe do të kryhen pa asnjë shtyrje në të gjitha rastet e mospërputhjes me dispozitat ligjore në fuqi pas *përfundimit*

*të zgjedhjeve studentore* dhe do të përfundohen brenda një periudhe prej 12 javësh duke u akorduar me procesin e implementimit të mëtejshëm të Statutit të UP-së.”

Pika S: “Këshilli Drejtues do të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të kryer zgjedhjet studentore pa shtyrje dhe në përputhje me dispozitat e Statutit, *me kusht që të jenë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për përmbarim profesional të zgjedhjeve.*

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve studentore do të zbatohen në procedurat e rizgjedhjeve të përcaktuara nga ‘zyrtarët e lartë’.”

### **Neni 3**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij

---

**Agim Veliu, ministër**